



AKEP
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE
AKEP

Nr. 1930 Prot.

Skup, më 21.10.2022



AGJENCIA E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE TË REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË SË VERIUT

AEK

Nr. _____ Prot. 1005-3022/1

Skup, më 21.10.2022

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Posare (AKEP) dhe Agjencia e Komunikimeve Elektronike e Republikës së Maqedonisë së Veriut (AEK),

më poshtë referuar me termin "Palët",

Duke njojur rëndësinë e shërbimeve të komunikimeve elektronike në zhvillimin e mirëqenies sociale dhe ekonomike për të dy vendet,

Duke marrë parasysh dhe duke :

- konsideruar interesin e përbashkët në promovimin e lidhjeve më të ngushta në fushën e komunikimeve elektronike;
- vlerësuar rëndësinë e infrastrukturës digitale në zhvillimin ekonomik e social te dy vendeve
- patur parasysh rëndësinë e konektivitetit/ndërlidhjes digitale si dhe ndikimin ne zhvillimet e ardhshme
- synuar nxitjen e zhvillimeve inovatore dhe teknologjitetë e së ardhmes 5G për një mbrojtje të nivelit të lartë të konsumatorëve, konkurrencës
- patur parasysh përfitimet që mund të lindin për te dy palet nga bashkëpunimi për çështje që lidhen me shkëmbimin e informacionit, përvojës dhe dokumentacionit në lidhje me zhvillimin e shërbimeve të komunikimit elektronik në të dy vendet
- marre ne konsidetare bazën e përbashkët për planet, programet dhe gatishmërinë e tyre për të mbajtur kontakte të rregullta dhe për të zhvilluar bashkëpunim praktik për çështje që lidhen me shërbimet e komunikimeve elektronike;

Të bindur për nevojën dhe dëshirën për bashkëpunim më të madh midis dy autoriteteve rregullatore, lidhin kete Memorandum Bashkepunimi:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është:

- 1.1 Bashkëpunimi midis palëve në hartimin e politikave dhe programeve për të adresuar sfidat rregullatore aktuale dhe ne të ardhmen në të dy vendet si edhe në rajon, bazuar në praktikat e mira të BE-së dhe angazhimet ndërkombëtare.
- 1.2 Zhvillimi i takimeve të rregullta midis përfaqësuesve të palëve si dhe hartimi i planeve të punës dhe kalendareve të përbashkëta, në përputhje me parashikimet ligjore, që rregullojnë fushën e veprimtarive dhe funksioneve të të dy palëve.

Neni 2

Angazhimi

1. Palët angazhohen që të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e këtij memorandumi në një mënyrë sa më të shpejtë dhe efikase si dhe për realizimin sa më cilësor të qëllimit të tij.
2. Palët angazhohen të bashkëpunojnë për:
 - a) Rritjen e bashkëpunimit dhe koordinimit per sa i përket implementimit në të ardhmen e afërt të gjeneratës së pestë të teknologjive mobile (5G) për rrjetet e komunikimeve elektronike, veçanërisht sa i përket harmonizimit ndërkufitar të frekuencave.
 - b) Rritjen e bashkëpunimit në fushën e harmonizimit të frekuencave ndërkufitare, ne preagtijen e marreveshjeve teknike dhe pershatjen e tyre me planet e perdonimit te frekuencave dhe harmonizimin e spektrit te frekuencave 5g.
 - c) Vijimin e bashkepunimit per zbatimin e marreveshjes RLAH per heqjaen e tarifave roaming midis vendeve te BP.
 - d) Vijimin e bashkepunimit per uljen dhe përshtatjen e tarifave të Roaming-ut midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian.
 - e) Per te shkëmbyer plane dhe raporte mbi shkallën e zbatimit të teknologjive të reja dhe digjitalizimin e shoqërive në të dy vendet.
 - f) Kryerjen e takimeve vjetore dy palëshe, në të cilat do të synohet të trajtohen çështje të përbashkëta dhe marrëveshje për çdo bashkëpunim të mëtejshëm, si dhe shkëmbim informacioni por pa u kufizuar në formë dhe kohë tjeter, (p.sh. pyetësorë, evenete specifike, raporte, informacion mbi aktivitetet në tregjet e komunikimeve elektronike etj.).
 - g) Krijimin e grupeve të përbashkëta ad hoc të punës, si mjet efektiv për vendosjen e një bashkëpunimi më të ngushtë teknik.
 - h) Organizmin e aktiviteteve te perbashketa per realzimin e qellimit te ketij memorandumi.

Neni 3

Komunikimi

- 3.1 Për efekt të zbatimit të këtij memorandumi, secila palë brenda afatit një mujor nga nënshkrimi i tij, të caktojnë personat, të cilët do të jenë përgjegjës në mënyrë që shkëmbimi i të dhënave dhe/ose informacioneve të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm dhe masat e nevojshme të merren në kohë.
- 3.2 Palët marrin përsipër që, përfundimisht, të zbatimit të këtij memorandumi të marrin të gjitha masat e nevojshme ligjore përfundimisht personat e përmendur në këtë nen me të gjitha lejet, urdhrat dhe/ose autorizimet e nevojshme përfundimisht të proceduar dhe/ose ndjekur apo përfundimisht të kryer komunikime ose njoftime, sipas përcaktiveve ligjore dhe atyre nënligjore specifike që rregullojnë veprimtarinë institucionale të secilës palë, në mënyrë të veçantë ato që kanë të bëjnë me komunikimet ose njoftimet jashtë institucioneve përkatëse.

Neni 4

Ndryshimet

- 4.1 Palët, kurdoherë, mund të bëjnë përmirësimet, ndryshimet ose shtesa në këtë memorandum.
- 4.2 Në çdo rast, çdo shtesë ose ndryshim do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e institucioneve përkatës dhe do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

Neni 5

Përdorimi i informacionit dhe konfidencialitetit

- 5.1 Të gjitha informacionet ose të dhënatur që do të merren në dëshira përfundimisht zbatim të këtij memorandumi, do të përdoren sipas kompetencave ligjore përkatëse të secilës palë dhe vetëm përfundimisht qëllimin e përcaktuar në këtë marrëveshje.
- 5.2 Çdo informacion dhe/ose e dhënë që do të shkëmbitet në dëshira përfundimisht zbatim të këtij memorandumi do t'i nënshtron parimeve të mirëbesimit (konfidencialitetit), me përfjashtim të atyre me karakter publik, të përcaktuara sipas akteve normative në fuqi.
- 5.3 Asnjëra prej palëve nuk ka të drejtë që të bëjë publike apo t'i kalojë, në çfarëdo lloj forme, të tretëve, informacionin ose të dhënatur që do të marrë nga pala tjetër, pa autorizimin eksplisit të saj.
- 5.4 Secila palë ka detyrimin që të trajnojë punonjësit përkatës që do të caktohen përfundimisht ndjekjen dhe zbatimin e përcaktiveve të këtij memorandumi, në lidhje me kufizimet e këtij nenit.

Neni 6

Afati i Memorandumit

- 6.1 Ky memorandum lidhet përfundimisht kohëzgjatje të pacaktuar.

- 6.2 Memorandumi mund të përfundojë nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjeter, të paktën 1 (një) muaj përpara.
- 6.3 Në rast të përfundimit të këtij Memorandumi, palët do t'u përbahen detyrimeve që rrjedhin nga ky memorandum, për sa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

Neni 7

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

- 7.1 Palët marrin përsipër respektimin dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga ky memorandum.
- 7.2 Memorandumi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.

Neni 8

Shfuqizime

- 8.1 Memorandumi i nënshkruar më 20 prill 2010, shfuqizohet.

Nënshkruar në Shkup, me date 21.10.2022, në dy kopje origjinale në gjuhët zyrtare të të dyja vendeve-Maqedonisht, në bazë të Kushtetutes së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Shqip, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqiperise, dhe Anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëlloj të vërteta. Në rast të mosmarreveshjeve për shkak të interpretimit të kësaj Marrëveshje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR AGJENCINË E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE TË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT

DREJTORI

Ž. Jeton AKIKU



PËR AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES

